



Republika e Kosovës  
Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Kuvendi i Komunës Rahovec  
RAHOVEC / ORAHOVAC  
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec

Njesia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)  
Nr./Br./No 01/102 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1  
Data/Datum/Date 27.08.2020



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja o) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 19 të Ligjit Nr. 02/L-57 për Institucionet Kulturore në Republikën e Kosovës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, 40 paragrafi 2 pika 2.8, 57 paragrafi 1 pika 1.15 dhe nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 merr këtë:

### V E N D I M

#### Për emërtimin e Muzeut të Qytetit "Ali Bajram Hasku"

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1052/20 i datës 10.08.2020 dhe merret vendimit për emërtimin e Muzeut të Qytetit në Rahovec me emrin "ALI (BAJRAM) HASKU", ish i burgosur politik për disa herë nga regjimi pushtues serb, pishtar atdhetar i arsimit shqip dhe veprimtar i njohur e i angazhuar për disa dekada për zgjidhjen e drejtë të çështjes sonë kombëtare..
2. Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

#### Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.102/20  
Datë: 27.08.2020

